



Mirësevini te ne, mirësevini te ju !

Nëse Valais ka peizazhe që mund të jenë në kartolinat më të bukura të Zvicrës, apo edhe më shumë, hijeshia e kantonit nuk ndalet vetëm në këto pamje të mrekullueshme të saj. Në të vërtetë, pasuria njerëzore e banorëve të saj është po aq e lartë sa edhe malet më të madhërishme të saj. Të jetosh në Valais është një fat !

Valais ka ditur të ruajë ekuilibrin mes modernitetit dhe të qenit vetvetja. Në të vërtetë, nga njëra anë kantoni ynë ka plotësuar zhvillimin e industrisë së vet, tregtinë dhe turizmin, të njohura botërisht, nëpërmjet sektorëve premtues si kërkimi shkencor dhe zhvillimi i sipërmarrjeve të reja. Por kantoni në të njëjtën kohë ka ditur të ruajë e të zhvillojë vlerat e afërta me natyrën e tij, lidhjet e tij të ngushta me traditën si dyluftimi i lopëve mbretëresha, vënien në pah të cilësisë së vreshtarisë së tij.


Valais është një tokë mikpritëse, por pret nga çdo i ardhur dhe e ardhur një integrim të përshtatur me rregullat e saj, duke respektuar besimin e gjithësecilit. Përzjerja kulturore është një shans për kantonin, që dëshiron të shkojë drejt prosperitetit. Për këto arsye është e rëndësishme që të mbizotërojë një frymë respekti reciprok në marrëdhëniet mes banorëve të tij. Zvicra është një shtet i së drejtës dhe kantoni ynë është i njohur për kultivimin e sensit të mirë në marrëdhëniet ndërnjerëzore.

Jepni nga vetja juaj në jetën lokale, duajeni Valenë dhe investimi juaj do t'ju kthehet shumëfish ! Që ta bëni këtë, ju do të gjeni, në faqet në vijim, në rrjetin e internetit dhe pranë njerëzve të administratës komunale dhe kantonale, të gjitha informacionet e nevojshme, që do të bëjnë të mundur suksesin e integritit tuaj.

Mirësevini në Kantonin Valais.

Frédéric Favre Këshilltar i Shtetit

Shefi i Departamentit të sigurisë,
institucioneve dhe sportit.



INTEGRIMI

Gjuha

Zvicra është një shtet 4 gjuhësh (gjermane, frënge, italiane dhe romansh, por zviceranët janë larg asaj që t'i flasin të katër gjuhët ! Vetë Valais është kanton 2 gjuhësh, domethënë fliten gjermanishtja dhe frengjishtja. Banorët e Valais së Epërme të luginës së Rhonit (kufiri gjendet në Sierre) flasin një dialekt gjerman i ashtuquajtur «Walisertitsch», por zyrtarisht komunikojnë në gjuhën gjermane. Banorët e pjesës së poshtme flasin në gjuhën frënge.

Është e rëndësishme ta **ruani gjuhën tuaj amtare**, por njëkohësisht ta mësoni edhe gjuhën që flitet në rajonin ku jeni vendosur. Me qëllim që të ruani gjuhën tuaj të origjinës dhe të takoni bashkëatdhetarët tuaj, ju mund të shkoni nëpër qendra takimi të drejtuara nga shoqata komunitare. Ekzistojnë kurse të gjuhës dhe kulturës së origjinës të organizuara nga ana e konsullatave (ose shoqata për prindërit). Në Sion dhe në Monthey ka biblioteka ndërkulturore në të cilat mund të gjeni libra në gjuhën tuaj amtare.

Për ta **mësuar gjuhën gjermane ose gjuhën frënge**, sigurisht ju mund të komunikoni me fqinjët dhe kolegët tuaj, mund të bleni metoda për të studiuar në shtëpi. Më rezultative dhe më e kënaqshme është të ndiqni kurset më të njohura. Ju mund të gjeni listën e organizatorëve të kurseve intensive të mbështetura nga kantoni duke ju drejtuar administratës tuaj komunale.

Nëse keni nevojë për një përkthyes (interpret) kryesisht në fushën mjekësore apo shkollore, ju mund të kërkonte, për Valais e poshtme në AVIC (shoqata Valaisane e përkthyesve të komunitetëve të ndryshme) dhe për Valais e Epërme në FMO. Përkthyesit e këtyre dy institucioneve janë të formuar për ndër-

mjetësimin kulturor mes dy komuniteteve, domethënë ata i njohin dy kulturat dhe të dy gjuhët dhe në të njëjtën kohë ata mund të përkthejnë fjalitë dhe të bëjnë shpjegimin e kontekstit.

Adresa

AVIC - Interprétariat communautaire (shoqata Valezane e përkthyesve të komunitetëve të ndryshme)

Avenue de la Gare 5
1950 Sion

Telefoni : 027 322 19 30

Mobili : 079 794 69 21

E-Mail : info@interpretavic.ch

Websiti : www.interpretavic.ch

FMO - Forum Migration Oberwallis (forumi për migrantët në Valais e Epërme)

Spittelgasse 2

3930 Visp

Telefoni : 027 946 82 85

Mobili : 079 852 05 11

E-Mail : info@forum-migration.ch

Websiti : www.forum-migration.ch

Integrimi

Qëllimi i politikës zvicerane të integrimit të të huajve është të përforcohet kohezioni social, t'u krijohet mundësia banorëve zviceranë dhe të huaj të jetojnë së bashku me një frymë respekti dhe tolerance raciproke dhe të realizojë barazinë e shanseve duke u lejuar të huajve të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe kulturore të Zvicrës.

Integrimi është një proces reciprok, i cili bën të jetojmë mirë së bashku përmes përshtatjes së ndërsjellë, në mes të popullsisë mik-pritëse që tregohet e hapur ndaj veçorive të migrantëve dhe vetë migrantëve që duhet të përshtaten me zakonet lokale.



Integrimi është një strategji e vështirë, sepse është ambicioze! Kjo strategji do të thotë që njëkohësisht ta ruash kulturën tënde dhe të jesh i hapur ndaj kulturës së tjetrit. Ajo kërkon njohjen e identiteteve të shumfishta dhe ndërtimin e urave dhe dialogjeve. Ajo gjithashtu nënkupton pranimin e vlerave themelore të shoqërisë mikpritëse, si barazia midis grave dhe burrave ose zgjidhja jo e dhunshme e konflikteve, duke përfshirë edhe ato brenda familjes.

Zyra kantonale për integrim

Zyra kantonale për integrim është pjesë e shërbimit të popullsisë dhe migrimit. Detyrat kryesore janë: zbatimi i planit kantonal për integrim, mbështetja, informimi dhe këshillimi i komunave dhe shërbimeve të tjera shtetërore në fushën e integrimit dhe luftën kundër diskriminimit, ndjekja e projekteve të mbështetura financiarisht nga ana e kantonit, këshilla dhe ndihmë për organizatat që mbartin projektet, migrantët dhe institucionet.

Adresa

SPM - Service de la population et des migrations

Avenue de la Gare 39
Case Postale 478
1951 Sion

Telefoni: 027 606 55 84
E-maili: SPM-integration@admin.vs.ch,
DBM-integration@admin.vs.ch
Websiti: www.vs.ch/integration

Shumica e qyteteve dhe disa komuna kanë **komisione për integrimin e migrantëve dhe përfaqësues për integrim**, të cilat gjithashtu mund t'ju ndihmojnë. Informoheni pranë administratës së komunës suaj.

Adresa të tjera


Ekziston një numër i konsiderueshëm institucioneve dhe shoqatash të cilat kanë mundësi për t'ju ndihmuar në integrimin tuaj. Një listë jo e plotë gjendet në faqen: www.vs.ch/integration.

Natyralizim (marrja e shtetësisë)

Ju si i huaj që banoni në Zvicër prej 12 vjetësh ose jeni kurorëzuar me një shtetas zviceran prej 3 vjetësh, me disa kushte, keni mundësi të fitoni shtetësinë zvicerane. Kërkesën mund ta bëni pranë zyrave shtetërore të popullatës rajonale.

Zyrtarët e gjendjes civile do t'u informojnë për kushtet e nevojshme dhe procedurën që duhet ndjekur.

Për më shumë informata: www.vs.ch/spm



TË punosh dhe të marrësh leje qëndrimi

Leja e qëndrimit

Çdo person që dëshiron të qëndrojë në Zvicër më shumë se tre muaj duhet ta ketë një leje qëndrimi. Këtë leje qëndrimi mund ta kërkon në zyrën e kontrollit të banorëve / zyra e pullatës së komunës (bureau du contrôle des habitants/office de la population) ku banoni. Ja llojet kryesore të lejeve të qëndrimit të cilat mund t'i merrni:

Leje qëndrimi të përkohshëm / L

Leje qëndrimi / B

Leje qëndrimi / C

Leje qëndrimi për kufitarë / G

Personat që vijnë përmes procedurës së kërkimit të azilit marrin këto leje të mundshme: Lejeqëndrimi B apo C për refugjatët me statut të njohur (të pranuar).

Lejeqëndrim i N për azilkërkuesit.

Lejeqëndrimi F për personat e pranuar përkohësisht.

Leja e qëndrimit L jepet në kuadër të një leje për punë e cila zgjat një vit në maksimum si dhe studentë. Lejeqëndrimi B është i vlefshëm nga 1 deri 5 vjet në varësi nga shtetësia e lejekërkuesit dhe mund të përsëritet.

Leja e qëndrimit C merret pas 10 vitesh qëndrimi të rregullt në Zvicër me një lejeqëndrim B apo pas 5 vitesh, nëse përmbushen disa kushte, sidomos kur personi është i integruar sa duhet.

Me disa leje qëndrimi mundësohet që të lëvizni gjeografikisht. Të gjitha lejet e qëndrimit e lejojnë lëvizjen për shkaqe profesionale si dhe bashkimin familjar.

Puna

Kushtet për të hyrë në tregun e punës varen nga shteti nga i cili vini: ato të Bashkimit Evropian (BE) apo të ashtuquajturat Shtetet e tjera.

Qytetarët që vijnë nga shtetet e Bashkimit Evropian përfitojnë nga marrëveshjet bilaterale. Përveç qytetarëve të Bullgarisë dhe Rumanisë, për të cilët ekzistojnë shumë kufizime, të gjithë të tjerëve u jepet mundësia të qarkullojnë (lëvizin) lirshëm në Zvicër, të ndërrojnë punëdhënësin dhe ta ndërrojnë lirisht vendbanimin.


Qytetarët e shteteve të tjera mund ta marrin lejen për punë vetëm e vetëm nëse kanë ndonjë kualifikim tepër të lartë dhe nëse u përgjigjen nevojave të ekonomisë tonë.

Për të gjithë, para se ta fillojnë punën është e domosdoshme ta marrin një autorizim qëndrimi dhe pune duke u paraqitur (lajmëruar) në zyrën e kontrollit të banorëve / zyra e pullatës së komunës (bureau du contrôle des habitants/office de la population) ku banojnë.

Njohja e diplomave

Ekziston mundësia për njohjen e diplomave të marra në shtetet e huaja.

Për studimet e nivelit profesional, organi kompetent për njohjen e diplomave, është Zyra federale e mësimit profesional dhe e teknologjisë (l'OFFT l'Office fédéral de la formation professionnelle et de la technologie). Për studimet universitare kujdeset Konferenca e rektorëve të universiteteve zvicerane. Në bazë tëpërvojës profesionale të fituar (në Zvicër apo në një shtet të huaj), ekziston mundësia të pranohen (mirënjohen) kompetencat dhe të merret një e ashtuquajtur («validation d'acquis») vlerësim i aftësive. Degët e ndryshme profesionale duhet të organizohen për ta bërë këtë vlefësim. Për këtë mund të informoheni te punëdhënësi i juaj, te sindikata juaj apo te Zyra e orientimit shkollor dhe profesional të pjesës frankofone të Valisit.



Në rast të humbjes së punës

Nëse e humbni punën, ju mundeni të përfitonit disa shërbime, pagesa nga zyra e sigurimit të punëve me kusht që t'i përmbushni disa kushte të caktuara.

Për këtë duhet të keni punuar në Zvicër, apo nën disa kushte të caktuara, në një shtet të Bashkimit Evropian apo të AELE-së, së paku 12 muaj brenda një periudhe prej 2 vitesh para se ta humbni punën. Lajmërohuni sa më shpejt që të jetë e mundur në zyrën rajonale të punësimit (ORP – Office régional de placement) të komunës tuaj.

Për më shumë informata: www.ch/cho-mage

Paga dhe sigurimi shoqëror

Në Zvicër nuk ekziston rroga minimale. Pagat caktohen nga sektori i aktivitetit. Ndalesat në rrogë të cilat janë në barrë të punëmarrësit dhe hiqen nga shuma e pagës bruto, janë prej 12 deri në 18 % të rrogës bruto (rreth 20 deri në 25 % në rast të taksimit në bazë). Këto ndalesa janë kotizime në sigurimet kryesore shoqërore: pensioni i pleqërisë (AVS), pensioni invalidor (AI), humbja e pagës (APG), papunësai (AC), aksident (LAA), shtesa familjare (LAF) dhe parashikim profesional (LPP).

Mbrojtja kundër humbjes së punës

Sindikatat, puna në të zezë.

Në rast mosmarrëveshjeje me punëdhënësin tuaj, në rast tëpushimit abuziv nga puna, në rast mobingu etj, mund t'i drejtoheni Shërbimit të mbrojtjes së punëtorëve dhe raporteve në punë (Le service de la protection des travailleurs et des relations au travail). Sindikata mund t'ju ndihmojë dhe t'ju këshillojë për këto procedura administrative.

Në rast se punoni në të zezë, nuk jeni të mbrojtur nga sigurimet shoqërore dhe nuk do të merrni kurrfarë dëmshpërblimi nëse e humbni punën, nëse jeni i sëmurë, i aksidentuar ose invalid. Plus asaj, duhet ta keni parasysh se jeni duke punuar në mënyrë ilegale. Pra mos pranoni ndonjë punë që nuk është e deklaruar!



FËMIJËT DHE SHKOLLA

Para fillimit të shkollës

Para shkollimit të detyrueshëm, ju keni mundësinë ta dërgoni fëmijën tuaj në çerdhe apo në kopësht. Gjithashtu mund ta lini fëmijën tuaj te prindër të tjerë, të përgaditur për ta ruajtur atë gjatë ditës. Informohuni për këtë pranë komunës ku banoni, e cila i ka të gjitha adresat e duhura për zonën ku jetoni.

Gjithashtu mund të zgjedhni ta lini fëmijën tuaj disa orë në javë në çerdhe të fëmijëve, madje edhe nëse nuk punoni, me qëllim që ta lehtësoni hyrjen e fëmijës suaj në shkollë, ta vini në kontakt me fëmijë të tjerë, që të familjarizohet (mësohet) me gjuhën frënge (nëse flisni një gjuhë tjetër në shtëpi).

Shkolla e detyrueshme

Hyrja në shkollën e detyrueshme, në ICH, fillon në moshën 4 vjeç. Ajo zgjat 11 vjet.

Regjistrimi në shkollë nuk bëhet automatikisht. Ju duhet të kontaktoni sekretarinë e Drejtorisë së shkollave (t'u përgjigjeni kërkesës së tyre për ta konfirmuar regjistrimin) apo ta kontaktoni sekretarinë e komunës së vendit ku banoni.

Shkolla e detyrueshme përbëhet nga nga shkolla fillore që zgjat 8 vjet (IH-8H) dhe Cikli i Orientimit që zgjat 3 vjet (9CO-11CO).

Nëse mbërrini në Valis gjatë shkollimit të detyrueshëm, fëmija juaj do të integrohet në klasën që i përgjigjet moshës së tij dhe nivelit të tij shkollor. Nëse niveli i tij shkollor është tepër i ndryshëm me klasën e tij, apo nëse nuk e flet mirë gjuhën frënge, do t'i propozohen masa dhe mbështetje specifike për një kohë 2 deri në 3 vjet, që nga 3H deri në 11CO, gjatë orarit të mësimt.

Nëse keni nevojë që të kujdeset dikush për fëmi jën tuaj jashët orarit të shkollës, ekzistojnë mensa shkollore vetëm për të ngrënë apo qendra pritëse për nxënësit (UAPE- unité d'accueil pour écoliers) të cilat organizojnë dhe marrin përsipër nxënësit

për të ngrënë, për t'i bërë detyrat dhe për aktivitete dëfryese derisa ju të ktheheni nga puna.

Shkolla nuk pret nga prindërit që të jenë në gjendje t'i bëjnë detyrat e fëmijëve të tyre. Por ajo pret nga prindërit që ta krijojnë një hapësirë dhe kushte të mira për mësim dhe të transmetojnë e të tregojnë interes të veçantë për shkollën.

Mësimdhënësit dhe drejtorja e shkollës janë në dispozicion për t'iu përgjegjur pyetjeve që doni t'i parashtroni. Mos hezitoni t'u drejtoheni atyre!

Kurse të gjuhës dhe kulturës së origjinës

Ambasadat dhe shoqatat organizojnë nganjëherë dhe janë përgjegjës të kurseve të gjuhës dhe kulturës së origjinës (LCO). Kjo u lejon fëmijëve të konsolidojnë mësimin e gjuhës së origjinës dhe të punojnë në aspektet të ndryshme kulturore të vendit të origjinës. Këto kurse jepen zakonisht jashtë orarit shkollor. Për informacione të mëtejshme, informohuni pranë ambasadave tuaja ose pranë shoqatave.

Pas shkollimit të detyrueshëm


Pasi t'i kenë mbushur 15 vjeç, fëmijët e kryejnë nivelin e shkollimit të detyrueshëm. Por askush nuk integrohet në tregun e punës pa e kompletuar shkollimin.

Në varësi të profesionit të zgjedhur dhe të interesit të fëmijës për shkollën dhe të rezultateve të arritura në mbarim të ciklit të orientimit, ai mund t'i zgjedhë dy drejtime të mundshme: mësimi i një zanati (apprentissage) apo vazhdimi i studimeve.

Mësimi në zanat (apprentissage) është një sistem i dyfishtë : nxënësi e mëson zanatin, profesionin e tij tek një punëdhënës dhe në të njëjtën kohë e vijon shkollën 1 apo 2 ditë në javë. Në varësi të profesionit, ky mësim zgjat 2 deri në 4 vjet.

Ekziston gjithashtu mundësia që ta vazhdoni shkollimin në nivelin e shkollës së mesme si në gjimnazet publike, shkollat superiore tregtare dhe shkollat e kulturës së përgjithshme apo shkollat paraprofesionale.

Në përgjithësi, kushti që një nxënës të regjistrohet në një Universitet, një Shkollë federale politeknike apo një Shkollë të lartë të specializuar është që ta ketë marrë diplomën e një gjimnazi (maturën).



SHËNDETI

Sigurimi shëndetësor, sigurimi aksidental, sigurimet plotësuese

Çdo person që qëndron në Zvicër (qoftë ai i rritur apo fëmijë) duhet të bëjë një kontratë të sigurimit shëndetësor pranë një sigurimi shëndetësor ziceran 3 muaj pas ardhjes në Zvicër. Shërbimet e sigurimit të obliguar shëndetësor janë plotësisht të njëjta te cilido sigurim shëndetësor.

Shuma e këstit që duhet paguar publikohet çdo vit në stinën e vjeshtës për vitin që vijon. Në këtë kohë jeni të lirë që ta ndërroni sigurimin, pa asnjë kufizim e as dënim.

Sistemi i sigurimit shëndetësor në Zvicër bazohet në konkurrencë. Kjo u jep mundësinë personave të siguruar ta zgjedhin siguruesin, shumën e franshizës dhe modelin e sigurimit. Në këtë sistem, të siguruarit mund të vendosin të paguajnë më lirë duke ndërruar sigurimin shëndetësor, duke zgjedhur një franshizë më të lartë apo duke zgjedhur një model sigurimi alternativ siç është Telmed apo një mjek familjar.

Çdo person e paguan një shumë të quajtur kësti mujor. Ky këst mund të ndihmohet me të holla nga shteti, në rast se personi apo familja ka të ardhura të pakta.

Një sigurim tjetër shëndetës jo i detyrueshëm, i quajtur plotësues, mund të kontraktohet gjithashtu për të përfituar disa ndihma në të holla siç janë mjekimet e dhëmbëve, kontrolli i shikimit (syve), mjekësia naturale, transporti dhe disa ilaçe.

Personat që punojnë më shumë se 8 orë në javë janë detyrtimisht të siguruar, kundër aksidenteve, nga punëdhënësi i tyre. Fëmijët dhe personat e papunë duhet të sigurohen për rrezik aksidenti pranë sigurimit të tyre.

Mjeku, spitali, mjekimi në shtëpi


Ju rekomandohet që sapo të vini në Zvicër të zgjidhni një mjek të përgjithshëm familjar si dhe një pediatër për fëmijë dhe t'u kërkonit atyre që t'ju çojë te specialisti në rast nevojë. Është mjeku juaj që duhet t'ju çojë drejt spitalit, nëse është e domosdoshme e t'ju shoqërojë në procedurat administrative.

Nuk duhet t'i përdorni urgjencat në spital si alternativë e mjekut tuaj familjar. Urgjencat e spitalit i trajtojnë vetëm rastet urgjente.

Në rast se gjendja juaj shëndetësore e kërkon atë, mjeku juaj mund t'u propozojë gjithashtu një mjekim në shtëpi, një ndihmë për ta mirëmbajtur shtëpinë, sjelljen e ushqimit të gatshëm në shtëpi, etj. Këto shërbime i kryejnë qendrat mjekësore shoqërore (CMS-Centres médico-sociaux).

Keni nevojë për një përkthyes?

Fjalori mjekësor ndonjëherë mund të jetë i ndërlikuar. Trajtimet mjekësore, mënyrat se si praktikohet shërbimi mjekësor në Zvicër mund të jetë i ndryshëm nga ai i vendit tuaj. Mos hezitoni të kërkonit ndihmën e një përkthyesi apo interpreti të komunitetit tuaj. Është shumë e rëndësishme të keni një dialog cilësor gjatë kontrollit mjekësor.



Shërbimet e pandërprera mjekësore-urgjencat


Nëse mjeku juaj familjar nuk është i lirë dhe keni një rast urgjence, sistemi i pandërprerë mjekësor telefonik ju mundëson që të viheni në kontakt me një mjek, një dentist apo me barnatoren kujdestare. Shërbimin e pandërprerë telefonik e sigurojnë mjekët roje prej orës 19h00 deri në ora 07h00 gjatë javës dhe 24 orë në 24 gjatë fundjavës dhe ditëve të festave

0900 144 033	Shërbimi mjekësor
0900 558 143	Shërbimi i dentistëve të Valisit roman
027 924 15 88	Shërbimi i dentistëve të Valisit të Epërm
0900 558 143	Barnatorja kujdestare
144	Shërbimi urgjent

Numri 144 mund të përdoret vetëm e vetëm në rast urgjence serioze për shëndetin. Mos shkoni drejtpërdrejt në urgjencat e spitalit më të afërt. Telefononi më parë dhe informohuni se në cilin spital duhet të shkoni dhe në këtë mënyrë do të jeni të mirëpritur, kur të mbërrini atje.

Numra të tjerë të dobishëm:

143	Lidhja telefonike e dëgjimit: dora e zgjatur (La main Tendue).
145	Helmimi
147	Lidhja telefonike e dëgjimit për të rinjë.



JETA SOCIALE DHE KULTURORE

Shoqata

U pëlqen kënga? Sporti? Kontaktet? Zvicra ka një **traditë të organizimit shoqëror**, që do të thotë se njerëzit angazhohen vullnetarisht për funksionimin e një klubi sportiv, një kori, një bande muzikore ose ndonjë grupi tjetër.

Keni mundësi të gjeni shoqata aktive në fushën e sportit, kulturës dhe sociale, gjithashtu edhe një lidhje me komunitetin tuaj të origjinës, me një fe apo me një parti politike. Komunitet zotërojnë **lista të shoqatave** aktive në territorin e tyre... Mund të informoheni edhe përmes internetit për të gjetur gjithçka që ju intereson përreth jush.

Jeta fetare

Kushtetuta federale dhe kushtetuta kantonale garantojnë **lirinë e besimit fetar**. Çdo person ka të drejtë të besojë ose jo, të praktikojë ose jo fenë që ka zgjedhur, duke e ditur se shumica e valezanëve janë katolikë. Ka vend për të gjitha fetë dhe ekzistojnë marrëdhënie të mira ndërjetare.

Në të gjitha komunat gjenden kisha katolike. **Vendet e tjera** të kultit (tempuj për protestantët, xhamia e vende të lutjes për muslimanët) janë të vendosura kryesisht nëpër qytete.

Kultura

Teatri, vallëzimi, muzika, piktura, letërsia... Oferta kulturore është e dendur dhe e shumëllojshme në Valais. Për të ditur se çfarë mund të «konsumoni» pranë jush, thjesht drejtohuni për tek **Zyra e Turizmit** gjithashtu në zyrën e **Shërbimit kulturor** të komunës suaj.

Shërbimi i kulturës së Valais i jep përkrahje zhvillimit profesional me anë të bursave dhe çmimeve. Ajo gjithashtu drejton muzeumet kantonale, mediatekat dhe arkivet.

Muzeumet kantonale janë 3: Muzeu i Artit i Valais, Muzeu Historik dhe Muzeu i Natyrës. Ato janë të vendosura në qendër të qytetit të Sionit. Vizita e muzeumeve zakonisht është falas vetëm të dielën e parë të muajit.

Mediateka kantonale gjendet në 4 qendra: në Brig, Sion, Martigny dhe St-Maurice. Pothuajse të gjitha komunat kanë mediateka, biblioteka ose vende leximi.

Është e mundshme të huazoni libra, gjithashtu të lexoni gazeta dhe revista, të huazoni filma, CD me muzikë dhe të përdorni edhe kompjuterat.

Ju si allofon (folës të një gjuhe tjetër) mund të kërkonte që të lexoni në gjuhën tuaj amtare. Në Valais ekzistojnë **2 biblioteka ndërkulturore** që vënë në dispozicion libra në mbi 60 gjuhë të ndryshme: «L'Ardoise» në Sion dhe «A TOUS LIVRES» në Monthey.


Bashkëjetesa

Nëpër fshatra njerëzit përshëndeten rregullisht ndërmjet tyre në rrugë. Në qytete kjo ndodh më rrallë.

Provoni të njiheni me fqinjët e ndërtesës apo edhe të lagjes tuaj. Një komunikim i mirë është garanci për raporte të mira fqinjësore.

Zvicranët njihen për të qetë dhe të kujdesshëm. Respektoni sa më mirë ambientet e përbashkëta dhe përshtatuni me banorët e lagje suaj.

Mundoheni të mos bëni zhurmë gjatë natës, të dielave dhe ditëve festive. Dhe bëni ndarjen e mbeturinave (nëpër thasë apo qese të veçanta).



Jeta politike

Zviceranët shpesh thirren për të votuar; mesatarisht 4 herë gjatë vitit. Të drejtat politike janë shumë të zgjeruara. Jo vetëm që kanë të drejtë të zgjedhin e të zgjidhen, por kanë edhe të drejtën e iniciativës dhe të drejtën e referendumit.

Qytetarët, përmes së drejtës së iniciativës mbledhin nënshkrime për të dalë në votime gjithëpopullore për të propozuar ndonjë ndryshim të kushtetutës. Qytetarët po ashtu përmes të drejtës së referendumit mbledhin nënshkrime për të kundërshtuar një ligj në parlament.

Disa kantone u japin të drejta politike të huajve. Kjo nuk vlen për kantonin e Valais.



FORMALITETE TË NDRYSHME ADMINISTRATIVE

Ndërrimi i vendbanimit

Të gjitha ndërrimet e vendbanimeve, gjithashtu edhe ato brenda komunës duhet të paraqiten brenda 14 ditëve në zyrat për kontrollimin e banorëve / zyra e popullsisë.

Ndryshimi i gjendjes civile

Lindje, martesë, vdekje... Në administratë është e nevojshme t'i lajmëroni ndryshimet kryesore të gjendjes suaj civile. Në Valais ekzistojnë 6 zyra për gjendjen civile : Brig, Visp, Sierre, Sion, Martigny, Monthey.

Mos harroni t'i paraqitni të gjitha ndryshimet në konsullatën ose në ambasadën e shtetit tuaj.

Kjo porosi vlen edhe për ata që kanë dy shtetësi.

Hapja e një llogarie bankare

Nuk ka kushte të veçanta për hapjen e një llogarie. Thjesht prezentohuni me një kartë identiteti.

Posta gjithashtu bën disa shërbime bankare.

Dërgimi i parave në shtet të huaj

Transferimin e parave në ndonjë shtet të huaj mund ta bëni përmes :

- Bankave
- Postave
- Kompanive për transferim të fondeve
- Sistemeve të pagesave online

Pagesa e tatimeve

Zvicra është një konfederatë dhe tatimet paguhen në 3 nivele : komunal, kantonal dhe nivel konfederal.

Për punëtorët dhe punëtorët e huaj që nuk zotërojnë një leje qëndrimi, tatimi u mirret direkt prej rrogës. Megjithatë ata duhet të dorëzojnë çdo vit deklaratën e tatimit.

Nëse keni vizën «C» ju duhet ta plotësoni çdo vit deklaratën e tatimit.

Ndërrimi i patentës së shoferit (lejes për vozitje)

Ju keni në dispozicion 12 muaj prej hyrjes në Zvicër, për të bërë ndërrimin e patentës tuaj me një patentë zvicerane. Shërbimi i qarkullimit rrugor ju njofton për hapat që duhet të ndërmirni.

Importimi i një automjeti

Nëse zotëroni një makinë më shumë se 6 muaj para ardhjes suaj në Zvicër, ju mundeni ta importoni makinën si të gjitha sendet tjera pa pagesë në doganë. Nëse e zotëroni atë prej më pak se 6 muaj, ju duhet të paguani një taksë importi.

Transportet publike

Transportet publike zvicerane janë efikase. Rrjeti është i dendur dhe i organizuar mirë.

Ofertat e shumta e bëjnë transportin publik më tërheqës dhe me çmime më të ulta.

Informoheni te stacioni i trenit apo autobusëve që ndodhet pranë jush.



Numéros de téléphone d'urgence

Policia	117
Zjarri	118
Dora e zgjatur (ndihmë dhe mbështetje morale përmes tel.)	143
Urgjencat	144
Helmimi	145
Linja për dëgjimin e të rinjve	147